



DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

THIRRJE PUBLIKE

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA
Nr.No.Br. 401-13135/8
Data-Date-Datum 17.06.2020
Klinë-Klina

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që veprojnë në komunën e Klinës, respektivisht të shoqatave të dalura nga lufta.

I. Komuna e Klinës – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, duke u bazuar në rregulloren MF - nr – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, u bën thirrje organizatave joqeveritare të shoqatave të dalura nga lufta që veprojnë në komunën e Klinës, të aplikojnë për mbështetje financiare për vitin 2020.

1. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare si në vijim:

- Vizitat e varrezave të dëshmorëve të Kombit
- Vizita familjarëve të dëshmorëve
- Vizita invalidëve të luftës
- Vizita familjarëve të të zhdukurve të luftës si dhe identifikimi i personave të pagjetur
- Organizimi i aktiviteteve të shoqatave të dalura nga lufta e UÇK-së
- Në fusha të tjera që i kanë në statusin e tyre.

II. Vlerësimi i projekteve do të bëhet nga një komision profesional 5-anëtarësh, të cilët do t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim dhe sipas rregulloreve për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Vlerësimi do të bëhet siç vijon më poshtë:

1. Plotësimi i kushteve administrative të aplikimit;
2. Ndërlidhja me objektivat e thirrjes;
3. Kapaciteti i dëshmuar organizativ dhe menaxhues;
4. Vazhdimësia e realizimit të programit dhe qëndrueshmëria e tij;

III. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë:

- Formulari i aplikimit- aplikacioni për projekt për OJQ- të ose projektpropozimi me kërkesë për subvencion;
- Dokumenti identifikues;
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së, numri fiskal, nëndega të jetë në Klinë;

1. 100%
2. 100%
3. 100%
4. 100%
5. 100%

- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit.

IV. Formulari për aplikim mund të merret në web-faqe të Komunës apo në zyrat e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe mund të dorëzohet duke filluar nga data **16.06.2020 deri më 25.06. 2020.** Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Aplikimet

1. OJQ-të në kuadër të kësaj thirrjeje mund të aplikojnë më së shumti me një projekt për secilën nga fushat e thirrjes.
2. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare të regjistruara në Ministrinë përkatëse dhe të cilat veprojnë në komunën e Klinës.
3. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Klinës - Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.
4. Para nënshkrimit të kontratës OJQ-ja duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të paguara, nëse është e aplikueshme.
5. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët apo projektpropozimin për përkrahjen e paraparë, të cilat së bashku me udhëzimet për aplikantët janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Klinës.
6. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht në këtë adresë: Komuna e Klinës, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërtesa e Kuvendit Komunal Klinë.
7. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Vërejtje: Projektet të cilat nuk i kanë të bashkëngjitura dokumentet sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave.

Klinë, 17.06.2020

DREJTORI

Skender MERTURI

